

KONTRATË

MBI "THEMELIMIN E SHOQËRISE SË THJESHTË"

"Moon Lounge"

Sot, me datë 17/02/2023, në Shkodër, Shqipëri, personi i mëposhtëm:

Z. Mikael Malocaj, shtetas shqiptar, lindur më **23/09/1999** lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J90923041M**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

dhe **Znj. Elizabeta Gjondrekaj**, shtetase shqiptare, lindur me **20/09/2001** lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftim me numër **K15920086W**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosën të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anetarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Emri i shoqërisë së thjeshtë është "**Moon Lounge**", këtu e më poshtë e quajtur "**Shoqëria**". Shoqëria është person juridik privat.

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërise së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kësaj kontrate themelimi dhe të legjislacionit në fuqi.



NENI 2

Adresa e shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresen: **Ndërtesa me nr. Pasurie 3/354, Rruga 13 Dhjetori, afer Bashkise, zona kadastrale 8594, Shkoder**

Shoqëria mund të hapë degë përfaqësimi në qytetet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

NENI 3

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë;

Bar-kafe .

NENI 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

NENI 5

Kapitali Themelor dhe Ortakët

Kapitali i Shoqërisë është 400000 Lekë (katërqind mijë).

Kapitali është shlyer nga anëtarët themelues në raportet e mëposhtme;

-nga Z. Mikael Malocaj, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 200.000 lek kapital

-nga Z. Elizabeta Gjondrekaj, 50% e kapitalit, me 1 kuotë, 200.000 lek kapital

Kapitali themelor është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anëtarët me themelimin e Shoqërisë.



NENI 6
Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi me i lartë vendim-marrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.

NENI 7
Administratori

Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administrator/e, i/të emeruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj. Mikael Malocaj, shtetas shqiptar, lindur më **23/09/1999** lindur dhe banues në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me numër **J90923041M**, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, nga data **17.02.2023 – 17.02.2028**. I rinovueshem, dhe, nese është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit, të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



NENI 8

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor 2023.

NENI 9

Të ndryshme

Kjo Kontratë Themelimi është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjten vlerë secila.

ORTAKËT E SHOQËRISË

MIKAEL MALOCAJ

MIKAEL MALOCAJ 

ELIZABETA GJONDREKAJ


Elizabeta Gjondrekaj